



I/e nderuar

Qendra Burimore për Drejtësi Tranzicionale e Universitetit të Prishtinës, Ambasada Mbretërore Norvegjeze në Kosovë, dhe Community Building Mitrovica ju fton të merrni pjesë në lansimin e projektit: "Mbeshtetje per Drejtësinë Tranzicionale"

Ky eveniment do të mbahet me 10 Dhjetor, 2018 në Gjykatoren e Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës duke filluar nga ora 9:00 e mëngjesit.

Projekti : "Mbeshtetje per Drejtësinë Tranzicionale " i mbështetur nga Ambasada Mbretërore Norvegjeze dhe i implementuar në bashkëpunim me Community Building Mitrovica (CBM) është një program Universitar me qëllimin e forcimit të rolit të Universitetit të Prishtinës në ndërtimin e paqes dhe pajtimin përmes edukimit. Gjithashtu me këtë projekt ne synojmë të rrisim bashkëpunimin mes Universitetit të Prishtinës dhe shoqërisë civile në Kosovë në fushat e Drejtësisë Tranzicionale, drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes.

Qëllimi i këtij projekti është të vazhdoj të rris kompetencat e Qendrës Burimore për Drejtësi Tranzicionale të Universitetit të Prishtinës përmes një programi i cili do të mundësoj edukimin e studentëve si një mënyrë për të kontribuar në ndërtimin e paqes, kulturës së bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut, mirëkuptimi kulturor dhe i komuniteteve si faktorë që qojnë drejtë ndërtimit të paqes.

Brenda kornizave të projektit bashkëpunimi me Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Oslo-së është paraparë si një mënyrë për të kontribuar në Internacionalizimin e Universitetit të Prishtinës. Stafit akademik i Universitetit të Prishtinës do të rris kapacitetet përmes bashkëpunimit me Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Oslo-së, të njohur si Universitet lider në zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes me programe dhe aktivitete në fushën e edukimit; studentët do të njohin dhe ekspozohen drejtë metodave të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe do të kenë mundësinë të ndëgjojnë prezantime nga profesorë nga Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Oslo-së gjatë konferencave dhe aktiviteteve të tjera të cilat do të zhvillohen si pjesë e projektit.

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë: implementimi i kursit zgjedhor mbi temën e drejtësisë tranzicionale në Universitetin e Prishtinës, vizita studimore për studentët në rajon që të njohohen me aktivitetet/proceset e drejtësisë tranzicionale, zhvillimi i programit MA të studimit në Të Drejtat e Njeriut, Paqe-ndërtimit dhe Drejtësisë Tranzicionale, paisja e QBDT me libra dhe materiale, programe praktike për studentë, aktivitete kërkimore të zhvilluara nga stafi akademik së bashku me studentët pjesëmarrës në program si dhe një konferencë ndërkombëtare.

Grupet e synuara janë: Studentët e Universitetit nga të gjitha komunitetet, studentët e punësuar (shërbyesit publik, aktivistë nga shoqëria civile dhe inividë të tjerë të interesuar) dhe stafi akademik. Më poshtë gjeni të bashkangjitur agjendën e eventit. Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen deri të Mërkurën, 05 Dhjetorë 2018, në adresën e mëposhtme: drejtësiastranzicionale@uni-pr.edu

Me respekt

Prof. As. Dr. Haxhi Gashi
Dekan i Fakultetit Juridik



Fakulteti Juridik - Universiteti i Prishtinës ‘Hasan Prishtina’

Qendra Burimore për Drejtësi Tranzicionale

Lansimi i Projektit “Mbështetje për Drejtësinë Tranzicionale” në Gjykatoren e Fakultetit Juridik , e hënë, 10 Dhjetor 2018 nga ora 9:00

Agjenda

09:00- 09:30	Regjistrimi i pjesëmarrësve (kafe)
09:30-10:30	Hapja/fjalët hyrëse -Prof Dr. Marian Demaj, Rektor i Universitetit të Prishtinës - Z. Shyqyri Bytyqi, Ministër i Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Znj. Atifete Jahjaga, ish-Presidente - Z. Strand Sjaastad, Ambasador i Ambasadës Mbretërore Moderator Prof.Asoc.Dr. Haxhi Gashi, Dekan i Fakultetit Juridik
10:45– 11:15	“Universiteti dhe Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile në 'Drejtësia Tranzicionale: Përvojat dhe perspektivat ” Folësit: - Prof.Dr. Iliriana Islami , Profesoreshë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, koordinatore e Projektit. -Znj. Afërdita Sylaj, Udhëheqëse Ekzekutive e Community Building Mitrova, Partnerë Implementues në Projekt -Z. Kushtrim Morina, Student Praktikantë në QBDT të Universitetit të Prishtinës Moderator Z. Metin Qestaj, Student pjesëmarrës në Projektin “Drejtësia Tranzicionale: Roli i Universitetit në Përballjen me të Kaluarën”-cikli i tretë.”
11:15 – 11:45	Diskutim i Hapur